



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo  
Komuna – Municipality  
Hani i Elezit



---

Nr. 04/ 8407 /2018

## DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

# RAPORT FINANCIAR PËR PERIUDHËN 1 JANAR- 30 SHTATOR 2018

**HANI I ELEZIT, TETOR 2018**

## Përmbajtja

1	Përkufizimet.....	3
2	Hyrje.....	4
2.1	Performanca e të hyrave.....	4
2.2	Performanca e shpenzimeve.....	4
3	Buxheti komunal 2018.....	5
3.1	Raporti i realizimit të buxhetit për periudhën janar-shtator 2018.....	5
3.2	Krahasimi i pagesave për periudhën janar-shtator 2018/17.....	6
3.3	Buxheti i komunës sipas drejtorive dhe kategorive ekonomike.....	7
4	Pagat dhe mëditjet për periudhën janar-shtator 2018.....	9
5	Mallrat dhe shërbimet për periudhën janar-shtator 2018.....	10
5.1	Shpjegime për mallrat dhe shërbimet.....	11
6	Shpenzimet komunale për periudhën janar-shtator 2018.....	13
7	Subvencionet dhe transferet për periudhën janar-shtator 2018.....	13
7.1	Shpjegime për kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere.....	13
8	Shpenzimet kapitale për periudhën janar-shtator 2018.....	14
9	Raporti i të hyrave vetanake për periudhën janar-shtator 2018.....	16
9.1	Shpjegime për të hyrat vetanake.....	17

## **1.Përkufizimet**

**Bilancet** - shumat e zotimeve të papritura, ndarjeve buxhetore të pa alokuara, alokimet e pa zotuar dhe çfarëdo të ardhurash të një shume më të madhe se sa shuma e shpenzimeve dhe zotimet e papritura të bartura nga viti fiskal paraprak;

**Organizatat Buxhetore** - të gjitha ministritë, komunat apo agjencitë dhe institucionet, të cilat pranojnë ndarje buxhetore nga Fondi i Kosovës;

**Zotimet** - shpenzimet e parashikuara, për të cilat urdhëresa për pagesë të zotimit është plotësuar në pajtim me Rregullat Financiare të Thesarit dhe të cilat janë regjistruar në SIMFK, pa marrë parasysh nëse i nënshtrohen apo jo ndonjë detyrimi ligjor;

**Kategoritë e shpenzimeve** - kategoritë “Pagat dhe Mëditjet”, “Mallrat dhe Shërbimet”, “Shërbimet Komunale”, “Subvencionet dhe Transferet” dhe “Shpenzimet Kapitale” .

**Viti fiskal** - periudhën nga 1 Janari i një viti deri 31 dhjetor të vitit të njëjtë;

**Alokimi i fondeve** – shuma maksimale për zotime dhe shpenzime që mund të bëhet kundrejt ndarjeve specifike buxhetore, siç është përcaktuar me procedurat e parapara në nenin 34 të LMFPP-së dhe të regjistruara në SIMFK;

**Subvencionet** – fondet e siguruar nga shteti për të ndihmuar kompanitë, personat juridik ose sektorët e veçantë të ekonomisë si për sh. bujqësia;

**Korniza Afatmesme e Shpenzimeve KASH**– Është një dokument i prioriteteve të politikave të Qeverisë që ka për qëllim orientimin e ndarjes së mjeteve buxhetore gjatë procesit të ardhshëm buxhetor. Përkrah parashikueshmërinë në procesin e buxhetit duke siguruar se buxheti bazohet në parashikimin afatmesëm makroekonomik dhe fiskal (zakonisht në një periudhë 3 vjeçare);

**Të hyrat vetanake të komunave** - çfarëdo e hyre e parasë publike e cila është vlerësuar dhe mbledhur nga komunat nga burimet e specifikuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108;

**Burimet e financimit** – grantet qeveritare, të hyrat vetanake, të hyrat e dedikuara, të hyrat nga AKP-ja dhe financimet nga huamarrja;

**Transferet** - Çdo ndryshim i ndodhur brenda ndarjeve të aprovuara të paraqitura në tabelat 3.1, 3.1 A, 3.1 B, 3.2, 3.2B, 4.1, dhe 4.2 nënkupton transferet që janë:

- ndryshimi i shumave të ndara në mes të organizatave buxhetore,
- ndryshimet që ndodhin mes nën-programeve të po të njëjtës organizatë buxhetore dhe
- ndryshimet e ndodhura mes secilës kategori të shpenzimeve të paraqitur në tabelën 3.1, 3.1A, 3.1B, 3.2, 3.2B, 4.1, dhe 4.2.

**Rialokimet** - Çdo ndryshim i ndodhur në tabelën 3.2, 3.2B; dhe 4.2 në kategorinë e shpenzimeve kapitale brenda një nën-programi të një organizate buxhetore;

## 2. Hyrje

Raporti financiar për periudhën janar- shtator 2018, është përgatitur në bazë të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të dispozitave të nenit 45, paragrafët 45.2 dhe 45.4, si dhe statutin e komunës së Hanit të Elezit të nenit 64, paragrafi 5.

Raporti financiar për periudhën janar-shtator 2018 ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe treguesit relevant rreth përmbushjes së planit, grumbullimit të mjeteve sipas burimeve të financimit, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan-programeve, dinamikës së mjeteve të shpenzuara sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë, si dhe treguesit tjerë që kanë treguar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë nëntëmujore.

### 2.1. Performanca e të hyrave

Të hyrat vetanake kanë shënuar trende rritëse prej rreth 19.02% që korrespondon me 36 mijë euro më shumë krahasuar me nëntëmujorin e vitit paraprak. Kjo rritje ka ardhur në masë të madhe nga të hyrat e tatimit në pronë, si dhe nga të hyrat indirekte (të hyrat e dënimeve në trafik).

### 2.2. Performanca e shpenzimeve

Shpenzimet buxhetore kanë arritur në 1,503 mijë euro përgjatë periudhës nëntëmujore të vitit 2018, apo 10.85% më shumë krahasuar me shpenzimet e krahasuara gjatë të njëjtës periudhë të vitit paraprak. Kjo rritje është nxituar nga ekzekutimi më i lartë nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime, të cilat janë rritur me 67.39% krahasuar me vitin paraprak, të pasuar me kategorinë shpenzime kapitale me 19.42%, një rritje nga kategoria e pagave dhe mëditjeve me 5.49% si rezultat i rritjes së pagave për të gjithë shërbyesit civil që marrin pagë nga Buxheti i Republikës së Kosovës, një rritje nga kategoria subvencione dhe transfere me 4.01%, ndërsa ajo e shpenzimeve komunale kemi një rritje prej 0.58%.

### *Ecuria e përgjithshme e këtyre treguesëve do të prezantohet për 12 programet buxhetore:*

1. Zyra e Kryetarit
2. Administrata e Përgjithshme
3. Zyra e Kuvendit Komunal
4. Buxhet dhe Financa
5. Shërbimet Publike dhe Emergjencë
6. Zyra Komunale për Komunitete
7. Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural
8. Zhvillimi Ekonomik
9. Planifikim Urban, Kadastra dhe Mbrojtja e Mjedisit
10. Shëndetësia
11. Shërbimet Sociale
12. Arsimi dhe Kultura.

### 3. BUXHETI KOMUNAL 2018

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2018 me Nr. 06/L-020 është në lartësi prej **2,766,745.00 Euro**, ndërsa ai përfundimtar është **2,998,316.45 €** (duke përfshirë bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2017 në shumë prej 181,517.77 € pastaj donacionet nga Demos-Grant i Performancës komunale në shumë prej 29,970.00 € donacionet nga Sharrcem në shumë prej 20,000.00 € si dhe donacionet e bartura nga viti i kaluar në shumë prej 83.68 €).

Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim:

- Paga dhe mëditje 1,444,207.00 €
- Mallra dhe shërbime 229,655.70 €
- Shpenzime komunale 44,532.66 €
- Subvencione dhe transfere 52,795.07 €dhe
- Shpenzime kapitale 1,227,126.02 €
- **Totali i buxhetit 2,998,316.45 €**

Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar-shtator 2018 është në shumë prej **1,503,347.24 €apo 50.14 %**.

Prej tyre për paga dhe mëditje janë shpenzuar 1,082,113.36 € apo 74.93 %, për mallra dhe shërbime 132,215.33 €apo 57.57 %, për shpenzime komunale 31,104.27 €apo 69.85 %, për subvencione dhe transfere 36,485.80 €apo 69.11 % dhe për shpenzime kapitale 221,428.48 € apo 18.04%.

#### 3.1 RAPORTI I REALIZIMIT TË BUXHETIT PËR PERIUDHËN JANAR-SHTATOR 2018

**TABELA 1.**

	TM3 2018				TM3 2017
	Buxheti fillestar (Ndarja)	Buxheti final (Ndarja)	Realizimi	Varianca	Realizimi
	A	B	C	D=C-B	E
<b>Hyra e parasë së gatshme</b>					
Të hyrat vetanake	303,597.00	303,597.00	226,534.08	(77,062.92)	190,332.51
<b>Gjithsejt Pranimet</b>	<b>303,597.00</b>	<b>303,597.00</b>	<b>226,534.08</b>	<b>(77,062.92)</b>	<b>190,332.51</b>
<b>Daljet e parasë së gatshme</b>					
Paga dhe mëditje	1,444,207.00	1,444,207.00	1,082,113.36	(362,093.64)	1,025,775.25
Mallra dhe shërbime	225,311.67	229,655.70	132,215.33	(97,440.37)	78,988.63
Shërbime komunale	44,532.66	44,532.66	31,104.27	(13,428.39)	30,924.35
Subvencione dhe transfere	51,103.67	52,795.07	36,485.80	(16,309.27)	35,077.60
Shpenzime kapitale	1,001,590.00	1,227,126.02	221,428.48	(1,005,697.54)	185,424.24
<b>Gjithsejt pagesat e bëra</b>	<b>2,766,745.00</b>	<b>2,998,316.45</b>	<b>1,503,347.24</b>	<b>(1,494,969.21)</b>	<b>1,356,190.07</b>

## Shpjegim

**Të hyrat vetanake** për këtë periudhë nëntë mujore 2018 janë realizuar në shumë prej 226,534.08 €apo për 36,201.57 Euro më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit 2017.

**Shpenzimi** për këtë periudhë nëntë mujore 2018 është realizuar në shumë prej 1,503,347.18 Euro apo për 152,649.17 Euro më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

### **3.2. KRAHASIMI I PAGESAVE PËR PERIU DHËN JANAR-SHTATOR 2018/2017**

**TABELA 2.**

KESH	Buxheti 2018	Realizimi TM3	%	Buxheti 2017	Realizimi TM3	%
Paga dhe mëditje	1,444,207.00	1,082,113.36	74.93%	1,393,609.01	1,025,775.25	73.61
Mallra dhe shërbime	229,655.70	132,215.27	57.57%	181,096.90	78,988.63	43.62
Shpenzime komunale	44,532.66	31,104.27	69.85%	44,988.58	30,924.35	68.74
Subvencione dhe trans.	52,795.07	36,485.80	69.11%	51,492.00	35,077.60	68.12
Shpenzime kapitale	1,227,162.02	221,428.48	18.04%	858,464.41	185,424.24	21.60
<b>TOTALI</b>	<b>2,998,352.45</b>	<b>1,503,347.18</b>	<b>50.14%</b>	<b>2,529,650.90</b>	<b>1,356,190.07</b>	<b>53.61</b>

#### Komente dhe shpjegime:

- Pagesat nga kategoria ekonomike **paga dhe mëditje** janë 1,082,113.36 €ose 74.93% të planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017 pagesat për këtë kategori kemi rritje për 5.49%.
- Pagesat për këtë kategori ekonomike **mallra dhe shërbime** për 9 mujin e vitit 2018 janë 132,215.27 €apo 57.57% e planit vjetor.
- Pagesat për **shpenzime komunale** për nëntë mujorin e vitit 2018 janë në shumë prej 31,104.27 €apo 69.85 % e planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017 kemi rritje për 0.58%.
- Pagesat nga kategoria ekonomike **subvencione dhe transfere** për nëntë mujorin e vitit 2018 janë në shumë prej 36,485.80 €apo 69.11% e planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi rritje me 4.01 %
- Pagesat nga kategoria ekonomike **shpenzimet kapitale** janë në shumë prej 221,428.48 apo 18.81%.
- Gjithsejt, **shpenzimet për periudhën janar-shtator 2018**, për të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimeve janë në shumë prej 1,503,347.18 €apo 50.14% e planit të përgjithshëm vjetor.

### 3.3. BUXHETI I KOMUNËS SIPAS DREJTORIVE DHE KATEGORIVE EKONOMIKE

TABELA 3.

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Alokimi	Mjetet e pa-alokuara	Shpenzimi	Zotim /Obligimet në pritje	Mjetet e lira	Progresi ndaj planit (%)
SUBCL / PCLASS	A	B	A - B	C	D	A - ( C + D)	E
<b>11 - PAGA DHE MËDITJE</b>	<b>1,444,207.00</b>	<b>1,082,113.36</b>	<b>362,093.64</b>	<b>1,082,113.36</b>	-	<b>362,093.64</b>	<b>74.93</b>
16035 - ZYRA E KRYETARIT	63,289.00	49,427.02	13,861.98	49,427.02	-	13,861.98	<b>78.10</b>
16335 - ADMINISTRATA DHE PERSONELI	97,476.00	73,358.30	24,117.70	73,358.30	-	24,117.70	<b>75.26</b>
16935 - ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL	52,088.00	41,124.09	10,963.91	41,124.09	-	10,963.91	<b>78.95</b>
17535 - BUXHET DHE FINANCA	56,564.00	36,549.75	20,014.25	36,549.75	-	20,014.25	<b>64.62</b>
18444 - SHERBIMET PUBLIKE DHE EMERGJENCE	59,083.00	44,105.47	14,977.53	44,105.47	-	14,977.53	<b>74.65</b>
19675 - ZYRA PER KOMUNITETE DHE KTHIM	7,436.00	0.00	7,436.00	0.00	-	7,436.00	<b>0.00</b>
47115 - BUJQESIA DHE PYLLTARIA	27,489.00	16,940.52	10,548.48	16,940.52	-	10,548.48	<b>61.63</b>
48035 - ZHVILLIMI EKONOMIK	21,234.00	11,984.38	9,249.62	11,984.38	-	9,249.62	<b>56.44</b>
66480 - PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI	55,297.00	39,405.48	15,891.52	39,405.48	-	15,891.52	<b>71.26</b>
73044 - ADMINISTRATA (SH)	16,193.00	10,857.71	5,335.29	10,857.71	-	5,335.29	<b>67.05</b>
75050 - SHËR.E KUJD.PRIM.SHËNDETËSOR	189,833.00	158,934.34	30,898.66	158,934.34	-	30,898.66	<b>83.72</b>
75671 - SHERBIMET SOCIALE	18,707.00	14,150.43	4,556.57	14,150.43	-	4,556.57	<b>75.64</b>
92175 - ADMINISTRATA (A)	33,107.00	25,761.63	7,345.37	25,761.63	-	7,345.37	<b>77.81</b>
94020 - ARSIMI FILLOR	597,063.00	450,626.38	146,436.62	450,626.38	-	146,436.62	<b>75.47</b>
95220 - ARSIMI I MESEM	149,348.00	108,887.86	40,460.14	108,887.86	-	40,460.14	<b>72.91</b>
<b>13 - MALLRA DHE SHËRBIME</b>	<b>229,655.70</b>	<b>191,238.58</b>	<b>38,417.12</b>	<b>132,215.33</b>	<b>30,792.46</b>	<b>66,647.91</b>	<b>57.57</b>
16035- ZYRA E KRYETARIT	22,000.00	18,500.00	3,500.00	14,760.97	799.12	6,439.91	<b>67.10</b>
16335 - ADMINISTRATA DHE PERSONELI	39,475.53	34,475.53	5,000.00	23,162.59	8,903.72	7,409.22	<b>58.68</b>
16935 - ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL	4,000.00	3,400.00	600.00	2,581.50	-	1,418.50	<b>64.54</b>
17535 - BUXHET DHE FINANCA	3,000.00	2,500.00	500.00	1,669.68	-	1,330.32	<b>55.66</b>
18444 - SHERBIMET PUBLIKE DHE EMERGJENCE	35,000.00	29,200.00	5,800.00	22,349.32	589.93	12,060.75	<b>63.86</b>
19675 - ZYRA PER KOMUNITETE DHE KTHIM	1,500.00	1,230.00	270.00	89.00	-	1,411.00	<b>5.93</b>
47115 - BUJQESIA DHE PYLLTARIA	3,000.00	2,500.00	500.00	2,336.96	-	663.04	<b>77.90</b>
48035 - ZHVILLIMI EKONOMIK	1,500.00	1,400.00	100.00	0.00	352.80	1,147.20	<b>0.00</b>
66480 - PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI	3,050.00	2,550.00	500.00	2,550.00	-	500.00	<b>83.61</b>

73044 - ADMINISTRATA (SH)	912.67	780.00	132.67	655.65	-	257.02	<b>71.84</b>
75050 - SHËR.E KUJD.PRIM.SHËNDETËSOR	60,287.50	50,810.50	9,477.00	45,064.33	5,729.82	9,493.35	<b>74.75</b>
75671 - SHERBIMET SOCIALE	3,931.00	3,223.00	708.00	827.15	390.00	2,713.85	<b>21.04</b>
92175 - ADMINISTRATA (A)	16,420.00	13,272.00	3,148.00	10,061.48	1,654.42	4,704.10	<b>61.28</b>
94020 - ARSIMI FILLOR	27,429.00	21,397.53	6,031.47	4,162.18	10,071.02	13,195.80	<b>15.17</b>
95220 - ARSIMI I MESEM	8,150.00	6,000.02	2,149.98	1,944.52	2,301.63	3,903.85	<b>23.86</b>
<b>14 - SHPENZIME KOMUNALE</b>	<b>44,532.66</b>	<b>35,177.78</b>	<b>9,354.88</b>	<b>31,104.27</b>	<b>-</b>	<b>13,428.39</b>	<b>69.85</b>
16335 - ADMINISTRATA DHE PERSONELI	25,999.66	21,000.00	4,999.66	20,996.07	-	5,003.59	<b>80.76</b>
75050 - SHËR.E KUJD.PRIM.SHËNDETËSOR	7,316.00	5,765.00	1,551.00	2,957.48	-	4,358.52	<b>40.42</b>
75671 - SHERBIMEET SOCIALE	900.00	675.00	225.00	501.52	-	398.48	<b>55.72</b>
94020 - ARSIMI FILLOR	8,000.00	6,000.02	1,999.98	5,385.02	-	2,614.98	<b>67.31</b>
95220 - ARSIMI I MESEM	2,317.00	1,737.76	579.24	1,264.18	-	1,052.82	<b>54.56</b>
<b>20 - SUBVENCIONE DHE TRANSFERE</b>	<b>52,795.07</b>	<b>44,241.40</b>	<b>8,553.67</b>	<b>36,485.80</b>	<b>2,800.00</b>	<b>13,509.27</b>	<b>69.11</b>
16035 - ZYRA E KRYETARIT	31,691.40	27,941.40	3,750.00	22,427.00	2,800.00	6,464.40	<b>70.77</b>
47115 - BUJQËSIA DHE PYLLTARIA	10,103.67	5,500.00	4,603.67	4,058.80	-	6,044.87	<b>40.17</b>
92175 - ADMINISTRATA (A)	11,000.00	10,800.00	200.00	10,000.00	-	1,000.00	<b>90.91</b>
<b>30 - SHPENZIME KAPITALE</b>	<b>1,227,126.02</b>	<b>1,136,976.30</b>	<b>90,149.72</b>	<b>221,428.48</b>	<b>309,384.49</b>	<b>696,313.05</b>	<b>18.04</b>
16335 - ADMINISTRATA DHE PERSONELI	71,810.64	71,810.64	-	21,700.60	-	50,110.04	<b>30.22</b>
18444 - SHERBIMET PUBLIKE DHE EMERGJENCE	110,000.00	97,394.01	12,605.99	29,758.55	37,627.95	42,613.50	<b>27.05</b>
66480 - PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI	873,003.48	797,661.75	75,341.73	105,285.04	250,989.02	516,729.42	<b>12.06</b>
75050 - SHËR.E KUJD.PRIM.SHËNDETËSOR	30,000.00	30,000.00	-	-	-	30,000.00	<b>0.00</b>
92175 - ADMINISTRATA (A)	142,291.58	140,089.58	2,202.00	64,684.29	20,767.52	56,839.77	<b>45.46</b>
94020 - ARSIMI FILLOR	20.32	20.32	-	-	-	20.32	<b>0.00</b>
<b>Totali i Përgjithshëm</b>	<b>2,998,316.45</b>	<b>2,489,747.42</b>	<b>508,569.03</b>	<b>1,503,347.24</b>	<b>342,976.95</b>	<b>1,151,992.26</b>	<b>50.14</b>

Në këtë tabelë kemi paraqitur buxhetin sipas drejtorive dhe sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve.



### Koment:

- ✚ Mjetet nga grantet qeveritare (fondi 10) janë shpenzuar në shumë prej 1,390,794.36 € apo 56.59%;
- ✚ Mjetet nga të hyrat vetanake (fondi 21) janë shpenzuar në shumë prej 43,676.41 € apo 14.39%;
- ✚ Mjetet nga të hyrat vetanake (fondi 22) janë shpenzuar në shumë prej 48,876.47 € apo 26.93%;
- ✚ Mjetet nga donacionet (fondi 32) janë shpenzuar në shumë prej 20,000.00 € apo 100.00%;
- ✚ Total shpenzimi nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake (fondet 10-21-22-32) janë shpenzuar në shumë prej 1,503,347.24 € apo 50.14%.

## 4. PAGAT DHE MËDITJET

### TABELA 4.

	TM3 2018	TM3 2017	Krahasimi
Përshkrimi	€	€	€
<b>Pagesat</b>			
Pagat neto përmes listës së pagave	922,131.93	875,470.41	46,661.52
Pagesa për sindikatë	3,167.00	3,137.06	29.94
Anëtarsim-Oda e infermierëve të Kosovës	442.97	-	442.97
Anëtarsim-Oda e mjekëve të Kosovës	193.18	-	193.18
Tatimi ndaluar në të ardhura personale	53,504.56	49,474.66	4,029.90
Kontributi pensional-punëtori	51,336.86	48,846.56	2,490.30
Kontributi pensional-punëdhënësi	51,336.86	48,846.56	2,490.30
<b>Gjithsej Pagesat</b>	<b>1,082,113.36</b>	<b>1,025,775.25</b>	<b>56,338.11</b>

## 5. PËRMBLEDHJE E MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE

**TABELA 5.**

KODI	Përshkrimi	TM3 2018	TM3 2017	Krahasimi 2018/2017 në %
13130	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit (transporti i nxënësve)	7,209.00	6,738.00	106.99%
13133	Shpenzimet tjera të udhëtimit zyrtar brenda vendit	366.50	285.00	128.60%
13141	Mëditjet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	1,876.6	999.56	187.74%
13142	Akomodimi i udhëtimit zyrtar jashtë vendit	2,550.50		0.00%
13310	Shpenzimet për internet	608.00	903.07	67.33%
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	5,818.16	4,587.14	126.84%
13330	Shpenzimet postare	1,474.78	1,326.00	111.22%
13430	Shpenzimet e ndryshme shëndetësore	127.84	60.00	213.07%
13460	Shërbimet kontraktuese tjera	48,051.28	5,494.18	874.59%
13470	Shërbimet teknike	0.00	296.97	0.00%
13480	Shpenzimet për anëtarësim	940.30	1,930.30	0.00%
13490	Shërbimet e varrimit	7,480.00	6,290.00	118.92%
13501	Mobilje (më pak se 1000 euro)	1,218.00		0.00%
13503	Kompjuter (më pak se 1000 euro)	148.00	-	0.00%
13509	Pajisje tjera (më pak se 1000 euro)	530.00	184.00	288.04%
13510	Blerja e librave dhe veprave artistike	240.00		0.00%
13610	Furnizime për zyre	4,863.80	3,322.98	146.37%
13620	Furnizime me ushqim dhe pije	9,686.55	9,029.20	107.28%
13630	Furnizime mjekësore	3,735.20	2,620.28	142.55%
13640	Furnizime pastrimi	1,664.64	1,546.20	107.66%
13770	Derivate për gjenerator	220.87	-	0.00%
13780	Karburante për vetura	11,177.11	12,949.38	86.31%
13917	Provizioni bankar	0.00	122.00	0.00%
13950	Regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve	2,730.42	2,987.42	91.40%
14010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	6,062.78	6,637.53	91.34%
14020	Mirëmbajtja e ndërtesave	996.50	2,210.72	45.08%
14023	Mirëmbajtja e shkollave	751.50	-	0.00%
14024	Mirëmbajtja e objekteve shëndetësore	313.00	-	0.00%
14032	Mirëmbajtja e auto rrugëve lokale	7,773.90	5,886.20	132.07%
14210	Reklamata dhe konkurset	400.00	60.00	666.07%
14220	Botimet e publikimeve	480.00	-	0.00%
14230	Drekat zyrtare	2,720.10	2,492.50	109.13%
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave	0.00	30.00	0.00%
	<b>Totali</b>	<b>132,215.53</b>	<b>78,988.63</b>	<b>167.39%</b>

## **5.1. SHPJEGIME NË KATEGORINË MALLRA DHE SHËRBIME**

### **13130-Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit**

Kanë të bëjnë me shpenzimet e transportit të nxënësve për realicionin Hani i Elezit-Krivenik-anasjelltas dhe Hani i Elezit – Kashan - Uji i Thartë – anasjelltas në shumë prej 4,284.00 € për periudhën janar-korrik 2018 si dhe transporti i nxënësve për realicionin Hani i Elezit - Kaçanik dhe anasjelltas në shumë prej 2,925.00 € për periudhën janar-korrik 2018.

### **13133- Shpenzimet tjera të udhëtimit zyrtar brenda vendit**

Ka të bëjë me shpenzimet e transportit për shëtitjen njëditore të nxënësve nëpër Kosovë në shumë prej 366.50 €

### **13142- Akomodimi i udhëtimit zyrtar jashtë vendit**

Ka të bëjë me shpenzimet e transportit (akomodimi dhe ushqimi) gjatë vizitës së këshilltarëve komunal në Shqipëri në shumë prej 2,550.50€

### **13460-Shërbime kontraktuese tjera**

Kemi angazhuar punëtor, konsulent të jashtëm me kontratë për shërbime të veçanta:

- 12 punëtorë në drejtorinë e shëndetësisë për 6 muaj, shuma prej 34,241.58 €
  - 2 punëtorë në drejtorinë e urbanizmit, kadastrit dhe mbrojtjes së mjedisit për 4 muaj (konsulent të jashtëm), shuma prej 4,466.55€
  - 1 punëtor në drejtorinë e shërbimeve publike për 6 muaj dhe 1 për 2 muaj, shuma e shpenzuar është 3,357.00 €
  - 1 punëtor në drejtorinë e arsimit për 3 muaj, shuma 1,088.40 €
  - 1 punëtor në drejtorinë e bujqësisë dhe pylltarisë për 5 muaj, shuma 1,722.80 €
- Është bërë pagesa për furnizimin me arkivole në shumë prej 985.00 €
- Është bërë pagesa për 1 vit për mirëmbajtjen e aparatit të GPS-it të drejtorisë së urbanizmit, kadastrit dhe mbrojtjes së mjedisit në shumë prej 420.00 €
- Është bërë pagesa në shumë prej 463.60 € për asgjësimin e barnave të mbetjeve medicinale.
- Është bërë pagesa për vendosjen e kamerave të SHFMU “Kështjella e Diturisë” në shumë prej 308.00 €
- Është bërë pagesa për blerjen e dyshekëve gjimnastikore sportive të SHML Dardania në shumë prej 998.35 €

### **13480-Shpenzimet për anëtarësim**

Kemi të bëjmë me shpenzimet për anëtarësim me Asociacionin e Komunave të Kosovës në shumë prej 940.30 €

### **13490-Shërbimet e varrimit**

Ka të bëjë me pagesën për 44 raste të varrimit në shumë prej 7,480.00 € prej tyre 16 raste kanë qenë (borxh i vitit 2017), si dhe 28 raste për periudhën janar-gusht 2018 .

### **13509- Pajisje tjera**

Kë të bëjë me furnizimin me klimë për depon e barnave në shëndetësi në shumë prej 290.00 € dhe furnizimin me një kosë për QPS-në në shumë prej 240.00 €

### **13620-Furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)**

Ka të bëjë me pije të ndryshme nga Ekzekutivi i komunës dhe Legjislativi (takime me donatorë, trajnime, mbledhje të ndryshme në sallë të kuvendit) në shumë prej 8,738.42 € për periudhën janar-shtator 2018, pastaj edhe furnizim me ushqim dhe pije 948.13 € për aktivitete të komunës, për data të rëndësishme si përvjetor të shkollës, ditë të infermierisë, aktivitete për barazi gjinore aktivitete për panair të bujqësisë etj.

### **13780-Karburante për vetura**

Ka të bëjë me shpenzimet e karburanteve për vetura për administratë komunale, sektori i shëndetësisë, sektori i pylltarisë dhe i zjarrfikësave, ku borxhet për muajt nëntor dhe dhjetor 2017 janë paguar në shumë prej 2,449.20 € kurse pjesa tjetër ka të bëjë për periudhën janar-gusht 2018 në shumë prej 8,777.80 €

### **14032- Mirëmbajtja e auto rrugëve lokale**

Ka të bëjë me mirëmbajtjen dimërore dhe verore të rrugëve në shumë prej 3,999.70 € pastaj mirëmbajtjen dhe zhbllokimin e kanalizimeve në shumë prej 3,774.20 €

### **14310-Dreka zyrtare**

Ka të bëjë me drekën zyrtare për nder të 17 shkurtit-Dita e Pavarësisë së Kosovës ku kanë marrë pjesë anëtarët e kuvendit komunal, ekzekutivi komunal, familjet e dëshmorëve, këshillat e fshatrave në shumë prej 320.00 € drekë zyrtare për nder të Epopejës së uçk-së ku kanë marrë pjesë anëtarët e kuvendit komunal, ekzekutivi komunal, familjet e dëshmorëve, këshillat e fshatrave në shumë prej 504.60 €

Darkë për 11 qershorin - Dita e Çlirimit në shumë prej 847.00 € ku kanë marrë pjesë: anëtarët e kuvendit komunal, ekzekutivi komunal, familjet e dëshmorëve, këshillat e fshatrave, anëtarë të Bashkësisë Islame të Kosovës, pjesëtarë të Policisë së Kosovës, pjesëtarë të Forcave të Sigurisë së Kosovës. Drekë zyrtare për KF "Sharri" dhe SHKA "Sharri" për ditën e çlirimit në shumë prej 606.00€ Drekë zyrtare për komisionerët gjatë mbajtjes së testit të maturës në shumë prej 207.00 € Drekë zyrtare për musafirë të ndryshëm në shumë prej 145.50 €

**TABELA 6. SHPENZIMET KOMUNALE**

	2018	2017	Krahasimi %
	TM3	TM3	TM3
Përshkrimi	€	€	
Rryma	25,084.09	24,739.98	1.39
Mbeturinat	5,400.85	5,584.00	-3.28
Shpenzimet telefonike	619.33	600.37	3.16
<b>Gjithsej Pagesat</b>	<b>31,104.27</b>	<b>30,924.35</b>	<b>0.58</b>

**TABELA 7. SUBVENCIONET DHE TRANSFERET**

	2018	2017	Krahasimi %
	TM3	TM3	TM3
<b>Pagesat</b>			
Subvencionet për entitetet publike	927.00	1,000.00	-
Subvencionet për entitetet jopublike	12,000.00	1,800.00	-
Pagesat për përfituesit individual	22,058.80	25,527.60	13.59
Pagesat e familjeve të të rënëve në luftë	1,500.00	6,750.00	-77.78
<b>Gjithsej Pagesat</b>	<b>36,485.80</b>	<b>35,077.60</b>	<b>4.01</b>

## 7.1. SHPJEGIME PËR KATEGORINË EKONOMIKE SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

### SUBVENCIONET PËR ENTITETE PUBLIKE

Është kryer obligimi për Ndërmarrjen publike lokale “Pastrimi” SH.A. në shumë prej 927.00 €

### SUBVENCIONET PËR ENTITETET JOPUBLIKE

Është ndihmuar Klubi i futbollit “Sharri” në shumë prej 6,500.00 € përmes shpalljes publike.

Është ndihmuar Shoqëria kulturore artistike “Sharri” në shumë prej 1,500.00€ Është ndihmuar Klubi i mundjes “Sharri” në shumë prej 1,000.00 € përmes shpalljes publike.

Është paguar kësti i parë në shumë prej 3,000.00 € bazuar në Marrëveshjen e bashkëpunimit në mes Komunës dhe OJQ *Help-Hilfe zur Selbsthilfe* për projektin “Programi i trajnimit për vetëpunësim” që ka të bëjë me ofrimin e trajnimeve të biznesit për 50 të rinjë nga Hani i Elezit dhe krijimit të vendeve të punës për 8 përfitues të granteve për vetëpunësim.

### PAGESAT PËR PËRFITUES INDIVIDUAL

Janë bërë pagesat në shumë prej 7,200.00 € për lehonitë (për 72 persona nga 100 € ku borxhe të vitit 2017 kanë qenë për 6 persona).

Janë kryer pagesat për fermerët në bujqësi në shumë prej 4,058.80 € (grurë, serra tunel, pula).

Janë paguar bursat e studentëve për 20 bursistë (20\*50 €=10M=10,000 €).

Është ndihmuar boksieri Shpend Kiki, si sportist i dalluar me 500.00 €

Është ndihmuar qytetari Shaban Ballazhi me 300.00 € për shkaqe shëndetësore.

### PAGESAT PËR FAMILJET E TË RËNËVE NË LUFTË

Kanë të bëjnë me pagesat e familjeve të dëshmorëve të rënë në Luftën e Maqedonisë (5-familje nga 150.00 € apo 1,500.00 € për dy muaj (2) muaj.)

## 8. LISTA E PROJEKTEVE KAPITALE PËR PERIU DHËN JANAR-SHTATOR 2018

**TABELA 8.**

Nr	Programi/përshkrimi	Granti qeveritar 10	Të hyrat vetanake 21	Të hyrat vetanake 22	Huamar rja në arsim 04	Donacionet 32-61	Total	Të shpenzuara
	<b>SHPENZIMET KAPITALE TOTALE</b>	<b>730,000</b>	<b>269,388</b>	<b>175,483</b>	<b>2,202</b>	<b>49,970</b>	<b>1,227,043</b>	<b>221,428.48</b>
<b>163</b>	<b>Administrata dhe Personeli</b>	<b>60,000</b>	<b>-</b>	<b>11,811</b>			<b>71,811</b>	<b>21,700.60</b>
44162	Pajisje me TI për administratë komunale	20,000					20,000	19,890.00
47199	Blerja e veturave zyrtare	40,000		10,000			50,000	
45624	Mbulimi i parkingut dhe rregullimi i garazhës për automjetet zyrtare			1,811			1,811	1,810.60
<b>180</b>	<b>Shërbimet publike dhe emergjenca</b>	<b>65,000</b>	<b>35,000</b>	<b>10,000</b>			<b>110,000</b>	<b>29,758.55</b>
45628	Riparimi i rrugëve dhe trotuareve të Hanit të Elezit	-	10,000				10,000	
41620	Fond për emergjencë	-	5,000				5,000	4,835.00
90573	Ndriçimi publik në zonat rurale të Hanit të Elezit	15,000	-	10,000			25,000	21,357.55
47216	Shtimi i kapaciteteve të ujit dhe rregullimi i rrjetit të ujës-jellësit	50,000	-				50,000	3,566.00
41622	Hulumtimi dhe furnizimi i fshatrave me ujë të pijshëm në (Paldenicë, Seçishtë, Gorancë)	-	20,000				20,000	
<b>660</b>	<b>Planifikim urban dhe mjedisi</b>	<b>500,000</b>	<b>234,388</b>	<b>88,583</b>		<b>49,970</b>	<b>734,388</b>	<b>105,285.04</b>
45700	Shtrimi me kubëza betoni i rrugicave nëpër zonat urbane të Hanit të Elezit	15,000					15,000	
45702	Shtrimi me kubëza betoni i rrugicave nëpër zonat rurale të Hanit të Elezit (Gorancë, Krivenik, Paldenicë, Pustenic, Seçishtë, Meliq, Dimcë, Lagja e re, Uji i Thartë)	60,000		50,000			110,000	
41641	Mjete të lira për bashkëinvestime	40,000		20,000			60,000	
41629	Rregullimi i kanalizimeve në lagjet e mbetura të zonës urbane të Hanit të Elezit	35,000					35,000	
45710	Rregullimi i kanalizimeve në lagjet e mbetura të zonave rurale të Hanit të Elezit (Rezhançë, Paldenicë, Gorancë, Dimcë, Lagja e re)	40,000					40,000	20,000.00
44173	Rregullimi i prockës dhe i kanalizimit fekal në	40,000					60,000	35,050.54

	fshatin Seçishtë					20,000		
45755	Asfaltimi i rrugës nga fshati Dermjak deri në fshatin Neqavcë	-	150,000				150,000	
45758	Rregullimi i burimit të ujit të thartë	15,000					15,000	
45761	Vendosja e kamerave në zonat rurale	-	10,000	15,000			25,000	
41632	Rregullimi i shtratit të Përroit të Dimcës - faza e dytë	-	10,000				10,000	
41627	Riparimi i Kompleksit të varrezave të dëshmorëve në Pustenic (Ndërimi i pllakave të lapidarit)	20,000	10,000				30,000	1,497.50
90613	Asfaltimi i rrugës Uji i Thartë – Pustenic	100,000				29,970	129,970	
41642	Fond për hartimin e projekteve	5,000	5,000	3,583			13,583	
45772	Rregullimi i prrockave dhe i kanalizimeve atmosferike ne zonat rurale	10,000					10,000	
41628	Fonde për shpronësim	-	5,000				5,000	5,000.00
47259	Rregullimi i rrugës Hani i Elezit – Gorancë	20,000					20,000	
41633	Hartimi i hartave zonale	-	10,000				10,000	
41631	Fasadimi i objekteve publike	-	10,000				10,000	
41640	Gjelbërimi i disa hapësirave publike	-	4,388				4,388	
47260	Asfaltimi i rrugës së varrezave të Lagjës së re	30,000	20,000				50,000	43,737.00
47262	Asfaltimi i trotuarit për këmbësor nga Hani i Elezit - Uji i Thartë	40,000					40,000	
47264	Ndërtimi dhe rregullimi i rrugës Gorancë-Krivenik	30,000					30,000	
<b>730</b>	<b>Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale</b>	<b>30,000</b>	<b>-</b>				<b>30,000</b>	
47280	Blerja e veturave zyrtare për QKMF dhe QPS	30,000					30,000	
<b>920</b>	<b>Arsimi dhe shkenca</b>	<b>75,000</b>	<b>-</b>	<b>65,090</b>	<b>2,202</b>		<b>142,292</b>	<b>64,684.29</b>
45667	Rregullimi i infrastrukturës shkollore	10,000		10,000			20,000	15,119.47
47281	Pajisja e qerdhës për fëmijë me paisje dhe inventar	15,000					15,000	
90631	Ndërtimi i qerdhës për fëmijë	10,000		40,090			50,090	40,666.20
45678	Pajisja me TI (laptop dhe projektor) për të gjithë arsimtarët	10,000		15,000			25,000	8,898.62
45685	Ndërtimi i rrethojës së SHML "Dardania"	10,000					10,000	
44179	Pajisja e kabineteve me mjete mësimore dhe laboratorike	20,000					20,000	
47282	Projekte për huamarrje në arsim				2,202		2,202	

## 9. RAPORTI I TË HYRAVE VETANAKE PËR PERIUdhËN JANAR-SHTATOR 2018

**TABELA 9.**

Nr	Përshkrimi	Planifikimi 2018	Realizimi TM3 2018	Realizimi TM3 2017	Progresi në %
		1	2	3	4=2/1
1	Certifikatat e lindjes	500.00	39.00	37.00	7.80%
2	Certifikatat e kurorëzimit	750.00	620.00	360.00	82.67%
3	Certifikatat e vdekjes	150.00	72.00	72.00	48.00%
4	Certifikata tjera ofiqarie	4,850.00	4,252.00	4,176.00	87.67%
5	Taksa për verifikimin e dokum. të ndryshme	60.00	50.00	29.00	83.33%
6	Taksa administrative	347.00	124.00	270.00	35.73%
<b>I</b>	<b>Administrata e Përgjithshme</b>	<b>6,657.00</b>	<b>5,147.00</b>	<b>4,944.00</b>	<b>77.47%</b>
7	Tatimi në pronë	112,000.00	95,043.52	62,762.70	84.86%
8	Taksë për regjistrim të automjeteve	15,000.00	13,480.00	12,270.00	89.87%
<b>II</b>	<b>Buxhet dhe Financa</b>	<b>127,000.00</b>	<b>108,523.52</b>	<b>75,032.0</b>	<b>85.45%</b>
9	Të hyrat nga reklamimet publike	10,000.00	2,680.00	8,882.50	26.80%
10	Licenca tjera për afarizëm	800.00	510.00	550.00	63.75%
12	Taksa tjera administrative	0.00	1,262.00		0.00%
12	Gjobat tjera	300.00	-	-	0.00%
<b>III</b>	<b>Shërbimet Publike</b>	<b>11,100.00</b>	<b>4,452.00</b>	<b>9,432.50</b>	<b>40.11%</b>
13	Të hyrat nga ushtrimi i veprimtar. afariste	100,000.00	60,258.6	63,821.80	60.26%
14	Licenca për pranimit teknik të lokalit	100.00	120.00	30.00	120.00%
<b>IV</b>	<b>Zhvillimi Ekonomik</b>	<b>100,100.00</b>	<b>60,378.60</b>	<b>63,851.80</b>	<b>60.32%</b>
15	Taksa komunale për leje ndërtimi	5,000.00	3,717.62	2,406.90	74.35%
16	Taksa komunale për demolim	270.00	40.00	10.00	14.81%
17	Taksë komun. për legalizim të objekteve	8,000.00	-	3,891.31	0.00%
18	Taksë për përcaktimin e hipotekës	2,000.00	1,594.00	2,121.00	79.70%
19	Taksë për bartjen e pronësisë	3,000.00	-	-	0.00%
20	Ndërrim destinimi i tokës	2,000.00	390.00	470.00	19.50%
21	Shërbime të ndryshme kadastrale	5,000.00	6,777.00	4,300.00	135.54%
22	Shfrytëzimi i pronës publike	6,000.00	1,989.04	2,928.30	33.15%
23	Te hyrat nga konfiskimet	0.00	-	2,415.00	0.00%
24	Gjobat nga inspektorati	200.00	415.00	-	207.50%
25	Ndarja e parcelave	6,000.00	-	1,633.00	0.00%
<b>V</b>	<b>Urbanizimi dhe Kadastri</b>	<b>37,470.00</b>	<b>14,922.66</b>	<b>20,175.51</b>	<b>39.83%</b>
26	Participimet në Arsim	150.00	-	-	0.00%
<b>VI</b>	<b>Arsimi</b>	<b>150.00</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>0.00%</b>
27	Taksa për shërbimet sociale	270.00	100.00	98.00	37.04%
28	Certifikata mjekësore	1,600.00	1920.00	1,728.00	120.00%
29	Participimet në shëndetësi	6,600.00	5,485.30	3,620.00	83.11%
30	Inspektimi Higjieniko-Sanitar	150.00	-	-	0.00%
<b>VII</b>	<b>Shëndetësia dhe MS</b>	<b>8,620.00</b>	<b>7,505.30</b>	<b>5,446.00</b>	<b>87.07%</b>
<b>A</b>	<b>TË HYRAT DIREKTE</b>	<b>291,097.00</b>	<b>200,939.08</b>	<b>178,882.51</b>	<b>69.03%</b>
31	Të hyrat nga dënimet në trafik	10,500.00	24,715.00	9,975.00	235.38%
32	Të hyrat nga dënimet në gjykata	2,000.00	880.00	1,475.00	44.00%
<b>B</b>	<b>TË HYRAT INDIREKTE</b>	<b>12,500.00</b>	<b>25,595.00</b>	<b>11,450.00</b>	<b>204.76%</b>
	<b>TOTALI I PËRGJITHSHËM (A + B)</b>	<b>303,597.00</b>	<b>226,534.08</b>	<b>190,332.51</b>	<b>74.51%</b>



## 9.1 SHPJEGIME PËR TË HYRAT VETANAKE

- Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2018 është në shumë prej 303,597.00 €
- Komuna e Hanit të Elezit ka arritur t'i arkëtoj gjithsejtë **226,534.08 €** të hyra vetanake për periudhën janar-shtator 2018 apo 74.62 % e planit të të hyrave vetanake.
- Të hyrat vetanake për periudhën janar-shtator 2018 janë më të larta për **36,201.57 €** apo për **19.02 %** se në periudhën e njëjtë të vitit 2017.

**Hani i Elezit**  
**Data: 08.10.2018**

**Drejtori për Buxhet dhe Financa**  
**Shabi Rexhallari**

---

**Kryetari i Komunës**  
**Rufki Suma**

---